



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN	
03 / Nr. / Br.	07/25
Nr. i fq. / Br. st	- 5 -
Data: / Datum	20.01.2025
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e XI-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13 dhjetor 2024 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloj në ora 10:15.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Mentor Hasani, Nurie Halili, Mensur Kasumi, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF-së).

Mungoi: Sylejman Mehollı.

Gjithashtu, në këtë mbledhje morën pjesë edhe drejtoret e drejtive, Fadil Hyseni, komandant i Njësisë së Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Vushtrri, Xhavit Mehmeti dhe Bujar Klinaku, anëtarë të komisionit për hartimin e Draft-Kodit Komunal të Etikës, Islam Latifi, nga Drejtoria për Shërbime Publike.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ajo tha se përmes postës elektronike na ka ardhur edhe një pikë shtesë: "Propozim-vendim për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2025".

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.11.2024
2. Draft-Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025
3. Draft-Plani i Punës i Kryetarit – Qeverisë Komunale për vitin 2025
4. Draft-Kodi Komunal i Etikës
5. Draft-Plani Komunal për Transport Lokal Publik të Udhëtarëve, 2024 - 2028
6. Informatë për shërbimet sociale dhe të asistencës në Komunën e Vushtrrisë
7. Raporti i Punës nga Njësia e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Vushtrri, për vitin 2024
8. Propozim-vendim për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2025
9. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.11.2024.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 15.11.2024.

2. Draft-Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025.

Melihate Basholli-Latifë, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – siç e dini, kuvendi e ka themeluar një komision për hartimin e Draft-Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2025. Komisioni e ka kryer punën e vet. Ka pak ndryshime nga plani i vitit të kaluar.

Agron Percuku, anëtar i KPF-së – e kisha pasë një propozim lidhur me dëgjimet buxhetore. Ne si anëtarë të KPF-së jemi të obliguar të dalim në terren dhe t'i dëgjojmë kërkesat e qytetarëve. Por, kur po vjen puna te realizimi i kërkesave të tyre, asnje prej tyre nuk po merren parasysh. Prandaj, nëse mundësohet ligjërisht, le të del vetëm qeverisja komunale në terren dhe t'i marrin kërkesat e qytetarëve, kurse mos të shkojnë fare anëtarët e KPF-së. Mos të na qesin në pozitë të palakmueshme si anëtarë të kuvendit, sepse ka pasur raste që përfaqësuesit nga qeveria komunale nuk kanë marrë pjesë fare në takim dhe ne jemi ballafaquar me kërkesa të ndryshme nga qytetarët dhe nuk kishim njohuri aq lidhur me planifikimet. Kur po vjen puna me shku me punu në planifikimin e buxhetit, po shkojnë anëtarët e qeverisë komunale jashtë vendit, kurse anëtarët e KPF-së jo.

Melihate Basholli-Latifë, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – tha se KPF-ja është bartës i procesit të dëgjimeve buxhetore. Mirëpo, duhet të ekzistojë një bashkëpunim më i madh me Drejtoren për Buxhet dhe Financa dhe me qeverinë komunale në përgjithësi, duke i marrë parasysh propozimet e qytetarëve që janë të arsyeshme.

Ergin Sunguri, drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural – kërkoi që të rregullohet në Draft-planin e punës emërtimi i drejtorisë, ku unë jam drejtor, sepse ka ndryshuar emërtimi. Pra, të jetë Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, si dhe i Drejtorisë për Investime Kapitale.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Draft-Plani i Punës i Kryetarit – Qeverisë Komunale për vitin 2025.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Draft-Kodi Komunal i Etikës.

Agron Percuku, anëtar i KPF-së – kisha kërkuar nga Xhaviti të na paraqet një rezyme të shkurtër lidhur me hartimin e këtij dokumenti.

Xhavit Mehmeti, anëtar i komisionit – deklaroi se ky është një dokument, i cili është unik në tërë Kosovën dhe është bërë në bashkëpunim me USAID-in para shumë viteve. Në këtë dokument, është një numër i madh i neneve që i kemi ndryshuar, modifikuar dhe e kemi përshtatur për rrëthanat aktuale. Ne i kemi ndjek të gjitha procedurat, ku kemi zhvilluar edhe një konsultim publik, ku janë dhënë disa propozime, të cilat i kemi përfshirë ato që kanë qenë të arsyeshme.

Melihate Basholli-Latifë, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – propozoi që të riformulohet nen 7, paragrafi 2 dhe të specifikohet edhe për veshjen e grave. Fjalën “ekstravagante” e

kisha hequr. Ajo propozoi që të jetë ky formulim “Zyrtarët publikë duhet të plotësojnë kërkesat e domosdoshme të veshjes serioze në ambientet e zyrës, burrat me xhaketë e këmishë, kurse gratë me veshje të përshtatshme e serioze, e preferueshme xhaketë e këmishë, pantallona ose fund, të paktën nën gju”.

Xhavit Mehmeti, anëtar i komisionit – tha se edhe ne si komision e kemi diskutuar këtë çështje, por nuk gjenim term më të butë të fjalës “ekstravagante”. Por, do ta riformulojmë këtë nen.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me gjashë (6) vota “për” rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Draft-Plani Komunal për Transport Lokal Publik të Udhëtarëve, 2024 - 2028.

Agron Percuku, anëtar i KPF-së – ky draft-plan është mjaft voluminoz, por i bazuar jo në dokumente zyrtare. Thuhet që është i bazuar në dokumente komunale, si Plani Zhvillimor Komunal (PZHK), harta zonale, e që komuna nuk ka PZHK, sepse i ka skaduar afati e nuk ka as harta zonale. Për kuvend do t'i paraqes vërejtjet e mia, por si dokument e përkrahu që të procedohet në kuvend.

Islam Latifi, nga Drejtoria për Shërbime Publike – theksoi se drejtoria ka pasur përsnim që ta hartoje këtë draft-plan brenda territorit të komunës, me qëllim që ta përmbrush një obligim ligjor. Deri më tani e kemi pasur një rregulllore përrregullimin e transportit brenda komunës. Në bazë të ligjit për transportin, komunat janë të obliguara ta hartojnë edhe këtë plan. Qëllimi i këtij plani është zgjerimi i shërbimit të transportit për të gjitha vendbanimet e komunës sonë, si dhe përmbrushjen e disa kriterieve teknike dhe ligjore, siç është ndërtimi i vend-ndaljeve të autobusëve jashtë shiritave rrugor në të gjitha vendbanimet ku operohet me autobus. Besoj që e keni informatën që është duke u hartuar PZHK-ja, ku është një grup punues teknik, i cili po bashkëpunon me operatorin ekonomik. Sa i përket hartës zonale, e kemi si draft, ku kemi të dhëna relevante shumë të rëndësishme. Po ashtu, ka filluar edhe hartimi i Draft-planit të mobilitetit, ku është një grup punues teknik që ka filluar punën dhe se UNHABITAT-i do ta mbështes këtë me 80 mijë euro.

Agron Percuku, anëtar i KPF-së – tha se PZHK-ja është jovalid dhe ne dhe qytetarët e dimë se pse s'po vjen në kuvend, kjo për shkak të interesave të ngushta të ndërtuesve që vend e pa vend të ndërtojnë objekte të larta. Ai kërkoi që t'ju caktohet një lokacion autobusëve për t'u ndalur, sepse është krijuar katrahurë nëpër qytet.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – tha se nuk e pashë në këtë draft që është caktuar ndonjë lokacion për stacionin e autobusëve. Sa herë që kalon kah pjesa e ish-stacionit të vjetër të autobusëve krijohet një katrahurë nga autobusët, kombi-busët, takside. Prandaj, është mirë t'ju bëhet një zgjidhje, sepse disa autobusë qarkullojnë në një rrugë e disa tjere në rrugën tjetër. Ajo propozoi që të gjendet një lokacion për ndërtimin e stacionit të autobusëve.

Te transporti publik e pashë vetëm transportin e nxënësve. A duhet të përfshihet edhe transporti për qytetarët tjera?

Islam Latifi, nga Drejtoria për Shërbime Publike – deklaroi se përveç transportit të nxënësve, ky plan i përmban edhe disa linja që aktualisht janë funksionale, duke përfshirë edhe kohën e nisjes qoftë nga Vushtrria apo nga vendbanimet. Ne kemi thënë që ky plan

ndërlidhet me këto dokumente strategjike, ku PZHK është në proces të hartimit, si dhe harta zonale është një draft. Kurse, plani i mobilitetit do të hartohej gjatë vitit të ardhshëm. Ne jemi kompetent vetëm për transportin brenda komunës, por nuk mund të mos përmendet transporti ndër-urban që përfshin linjën Mitrovicë – Prishtinë, e që kalojnë përmes Vushtrrisë.

Sa i përket stacionit të autobusëve, nuk kemi pasur mundësi ende ta adresojmë, sepse mungon hapësira.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Informatë për shërbimet sociale dhe të asistencës në Komunën e Vushtrrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

7. Raporti i Punës nga Njësia e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Vushtrri, për vitin 2024.

Agron Percuku, anëtar i KPF-së – tha se e përgëzon njësinë për këtë raport që na e ka sjell. Por, është shqetësuese çështja e ujit, që ua vështirëson punën edhe zjarrfikësve. Prandaj, qeverisja lokale ta ketë prioritet çështjen e ujit, në mënyrë që t'u lehtësohet puna qytetarëve, por edhe zjarrfikësve.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – edhe pse kanë sjell pak material në raport, por punë dhe aktivitete të shumta nga Njësia e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit. Zjarrfikësit kryejnë një punë të shenjtë, duke rrezikuar shëndetin e tyre për t'i ndihmuar të tjerët.

Fadil Hyseni, komandant i Njësisë së Zjarrfikjes dhe Shpëtimit – tha se ky raport është në formë të shkruar dhe tabelare. Ka edhe krahasime me vitin paraprak. Ai tha se ka qenë vit sfidues për ne si njësi. Fatmirësish, zjarre kemi pasur shumë pak këtë vit. Bartja e ujit ka qenë sfidë për ne. Sa i përket aksidenteve, ne marrim pjesë vetëm kur ka njerëz të lënduar. Prandaj, si këshillë e imja është që në aksidente, mos t'i prekin personat e lënduar njerëzit e paautorizuar, sepse shumë herë ndodhë që e dëmon tonë të aksidentuarin.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

8. Propozim-vendim për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2025.

Agron Percuku, anëtar i KPF-së – meqenëse kjo pikë, edhe shumë pika tjera lidhen me Planin Zhvillimor të Komunës dhe duke e pasur parasysh që komuna po vepron pa PZHK, kjo qeverisje po punon shkel e shko. Nuk është mirë të publikohet të gjitha pronat. Është mirë që të lihen edhe për gjeneratat tjera që vijnë pas neve. Ndoshta, gjeneratat tjera punojnë me ndonjë plan më të mirë. E jo sikur tash që u jepen në shfrytëzim pronat për interesa të ngushta. S'po lihet asnjë pronë për investim në të mirë të qytetarëve.

Kjo listë a është në bazë të interesave të komunës, apo në bazë të kërkesave të qytetarëve?

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – tha se prej 57 parcelave që figurojnë në listë, vetëm dy janë në qytet. Ku gjenden saktësisht këto dy prona? A janë të përfshira pronat e fundit

apo ka edhe prona tjera që do të jepen në shfrytëzim vitin e ardhshëm. Gjithë këto prona që janë, nuk kemi hapësirë për stacion të autobusëve, çerdhe, park.

Azem Bejta, udhëheqës i sektorit për pronë – sa i përket publikimit të listës së pronave, një pjesë e tyre bëhet në bazë të kërkesave të qytetarëve. Ai tha se ligji na obligon që të publikohen pronat që janë të mundshme të jepen në shfrytëzim. Ligji nuk e përcakton se cila pronë duhet të jepen e cila jo. Në këtë listë ka prona që kanë qenë edhe viteve të kaluara, por ka pasur interesim nga qytetarët dhe është përsëritur. Por, ka edhe prona të reja që janë përfshirë në listë në bazë të kërkesave të qytetarëve. Sa i përket dy parcelave në Vushtrri, një parcelë gjendet te “Extra color”, ku një qytetar ka kërkuar 200m. Kurse, parcela tjetër gjendet përballë çezmës tek “Kalaja”.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – kjo prona te “Kalaja”, aty banesat janë imazh i keq i qytetit. Komuna duhet t’i rinojovë ato banesa dhe atë parcelë më mirë është t’ua lë banorëve të banesave në shfrytëzim.

Agron Percuku, anëtar i KPF-së – lidhur me parcelën përballë çezmës tek “Kalaja” gjendet edhe një rrugë dhe disa objekte prapa banesave. Në seancat e kaluara kam kërkuar që administrata e NPL “Përparimi” të vendoset aty, por ende nuk asgjë në këtë drejtim. Prandaj, më e rrugës do të ishte që qeveria komunale ta shqyrtojë këtë propozim për vendosjen e administratës së NPL “Përparimi” aty, sesa t’i jepet dikujt në shfrytëzim, i cili e shfrytëzon vetëm pjesën e vet. Pra, le të lirohet ajo rrugë aty.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me gjashtë (6) vota “për”, një (1) “abstenim” rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

9. Pyetje dhe përgjigje.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – pyeti se a është duke vazhduar pagesa e subvencionimit për fëmijët e porsalindur?

Mbledhja përfundoi në orën 11:10.

Bujar Klinaku



Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi

Kryesuese e KK-së dhe KPF- së

